

Njoftim për përqendrim, me të cilin NLB Skladi – Zeleni Prehod I A, shoqëri e dedikuar për investime, sh.p.k., Slloveni, do të fitojë kontroll mbi shoqërinë RESALTA NDRIÇIMI PUBLIK DHE RINOVIMI ENERGETIK I NDËRTESAVE SH.P.K. BEOGRAD, Serbi.

(lënda nr. 08-94/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 04.06.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit nga ana e NLB Skladi – Zeleni Prehod I A, shoqëri e dedikuar për investime, sh.p.k., me seli në Tivolska cesta 48, 1000 Lubjanë, Slloveni, mbi shoqërinë RESALTA NDRIÇIMI PUBLIK DHE RINOVIMI ENERGETIK I NDËRTESAVE SH.P.K. BEOGRAD me seli në Beograd, Braqa Baruh 24, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

NLB Skladi – Zeleni Prehod I A, shoqëri e dedikuar për investime, sh.p.k., është pjesë e Grupit NLB.

Grupi NLB në Republikën e Maqedonisë së Veriut aktualisht ka 3 shoqëri të ndërlidhura:

- NLB Banka SHA Shkup, me seli në rr. Vodnjanska nr. 1 Shkup, me veprimtari prioritare – ndërmjetësim monetar tjetër,
- Shoqëria për lizing NLB LEASE&GO SHPK Shkup, me seli në rr. Vodnjanska nr. 1 Shkup, me veprimtari prioritare – lizing financiar, dhe
- Shoqëria për menaxhimin e fondeve të hapura dhe të mbyllura investuese NLB Fondovi SHA Shkup, me seli në bulevardin Partizanski Odredi nr. 14A-1/2 Shkup, me veprimtari prioritare: menaxhim fondesh.

Veprimtaria e regjistruar e RESALTA NDRIÇIMI PUBLIK DHE RINOVIMI ENERGETIK I NDËRTESAVE SH.P.K. BEOGRAD është aktivitet inxhinierie dhe këshillim teknik.

RESALTA NDRIÇIMI PUBLIK DHE RINOVIMI ENERGETIK I NDËRTESAVE SH.P.K. BEOGRAD nuk ka subjekte të ndërlidhura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar qarkullim gjatë vitit 2024 në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit, përqendrimi i propozuar i referohet tregjeve të:(i) ofrimit të shërbimeve për efikasitet energjetik në ndërtesat publike në Serbi; dhe (ii) ofrimit të shërbimeve për rikonstruktimin e sistemit të ndriçimit publik në Serbi.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë pranë Komisionit brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

10.06.2025

Shkup